



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

RELACION

Data	
Nr. Prot	

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR

SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR
SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. RONALD THOMA ZHEZHA, KANDIDAT PËR ANËTAR NË
KËSHILLIN E BASHKISË FIER, QARKU FIER I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR
KOALICIONI "BASHKË FITOJMË"

Referuar neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia nje shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe "Kandidati /Anëtari në Këshillin e Bashkisë".

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Ronald Thoma Zhezha, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Fier, më datë 31.3.2023, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. 6964 unik. KQZ bëri verifikimin "prima facie" dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Ronald Thoma Zhezha, nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë në sistem, rezulton i padënuar.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Ronald Thoma Zhezha, rezulton të

ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile, ka ndryshuar rubrikën e emrit nga “Roland” në “Ronald”.

II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Ronald Thoma Zhezha.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Ronald Thoma Zhezha, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjenezalitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se ka ndryshim tek gjenezalitetet e tij; Emri i mëparshëm: Roland;
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 7 “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?”, subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”, Është marrë masa e dëbimit nga shteti Italian në vitin 2000, për arsyen “Emigrim i paligjshëm”.
- Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”; Subjekti i vetëdeklarues ka jetuar për afatin kohor 2 muaj në shtetin Grek dhe 3 muaj në shtetin Italian për arsye emigrimi.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4266 prot., datë 26.4.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 657/31 prot., datë 12.9.2023, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Ronald Thoma Zhezha. Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, ka miratuar rezultatit e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Ronald Thoma Zhezha, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Rezulton të ketë kryer ndryshime më datë 28.07.2011, në përbërësit e gjendjes civile, rubrikën e emrit nga “Roland” “Ronald” ;
- Nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë, nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj;
- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Nuk rezulton të ketë qenë në hetim apo gjykim, nga ndonjë autoritet gjyqësor për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk rezulton të ketë qenë i arrestuar në flagrancë apo ndaluar nga organet ligjzbatuese shqiptare për kryerjen e ndonjë vepre penale;
- Nuk rezulton ti jetë caktuar ndonjë masë shtrënguese e sigurisë personale;
- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndonjëherë ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale;
- Nuk rezulton të jetë marrë për të ndonjëherë masa e dëbimit nga një shtet i huaj, për kryerjen e ndonjë vepre penale apo për cënim shumë të rëndë serioz të sigurisë publike, (është kthyer për shkelje të ligjit mbi Emigracionin).
- Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion me qëllim verifikimi të mëtejshëm:
 - për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - për qënien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
 - për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
 - dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - përdorimin e të dhënave personale/gjenealiteteve të tjera.

III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

Ligji nr. 138/2015 dhe vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjenealitetet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime arrestime, hetime, etj).

Për sa më sipër subjekti vetëdeklarues, z. Ronald Thoma Zhezha, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Fier, Qarku Fier i propozuar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që

zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhshmërisë.

Koalicioni “Bashkë Fitojmë” në Këshillin e Bashkisë Fier, Qarku Fier ka fituar 15 (pesëmbëdhjetë) mandate dhe z. Ronald Thoma Zhezha, kandidat i listës shumëmemërore të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” në Këshillin e Bashkisë Fier, Qarku Fier në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, nuk ka marrë mandatin e anëtarit të këshillit.

Valbona BALLGJINI - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Majlinda ÇELMETA - Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm